

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6837
E martë, 2 mars 2023
çmimi 0.40 €

Finlanda, më afër
pranimit në NATO
pa Suedinë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPOZITA E NDARË RRETH PRANIMIT TË PROPOZIMIT EVROPIAN

| FAQE 4-5



Dy partitë më të mëdha opozitare në vend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë kritikuar pranimin e propozimit evropian nga

kryeministri Albin Kurti. Sipas këtyre dy partive, me këtë propozim për normalizimin e raporteve me Serbinë, Kosova ka humbur njohjen e ndërsjellë dhe ka pranuar ta themelojë

Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ndryshe nga PDK-ja dhe LDK-ja, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka përkrahur propozimin evropian

OPINION

KOSOVA ME SOVRANITET POST-WESTPHALIAN F. 6

Dr. Sc. Salihe SALIHU



AKTUALE

KUVENDI I MAQEDONISË SË VERIUT MIRATON RIORGANIZIMIN E QEVERISË F. 3

25 VJET NGA FILLIMI I LUFTËS NË KOSOVË F. 6

BISLIMI PËRMEND TRI KUSHTE PËR FORMIMIN E ASOCIACIONIT F. 7

EKONOMI



UNDP PUBLIKON RAPORTIN MBI SFIDAT DHE MUNDËSITË NË KALIMIN NË NJË EKONOMI NEUTRALE NDAJ KARBONIT F. 8

MINISTRIA E BUJQËSISË HAP PERIUDHËN PËR APLIKIM PËR SUBVENCIONE PËR VITIN 2023 F. 8

SPORT



MINISTRI ÇEKU: PROCESI I LICENCIMIT TË FEDERATAVE, DREJT PËRFUNDIMIT F. 10

WEBER: NËSE NUK U PAJTUAN PËR ASOCIACIONIN, NUK PATËN MARRËVESHJE

| FAQE 3



KMDLNJ: SHITJA E RRYMËS PËRKEQËSON GJENDJEN EKONOMIKE TË SHUMICËS SË QYTETARËVE

| FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut miraton riorganizimin e qeverisë

SHKUP, 28 SHKURT - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka votuar të hënën pasmesnate riorganizimin e qeverisë, duke përfshirë në të edhe ministra të Aleancës për Shqiptarët, e cila është bërë pjesë e shumicës parlamentare.

Ministër i ri i Drejtësisë është zgjedhur Krenar Llogar, ministër i Shëndetësisë, Fatmir Mexheti, ministër i Administratës Publike dhe Shoqërisë Informatike, Azir Aliu, ndërsa Kaja Shukova për ministre të Ekologjisë.

Ndryshimet janë miratuar me 65 vota nga 120 sa janë gjithsej. Riorganizimi i qeverisë së kryeministrit Dimitar Kovaçevski ka ardhur pas vendimit të partive në pushtet, Lidhjes Social Demokrate (LSD) dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI) për zgjerimin e shumicës parlamentare, duke përfshirë edhe Aleancën për Shqiptarët.

Kryeministri Kovaçevski ka

thënë se zgjerimi bëhet me qëllim të forcimit të shumicës për vazhdimin e kursit të integritimit evropian të Maqedonisë së Veriut. “Deputetët e VMRO-DPMNE-së për dy javë bllokuan zgjedhjen e ministrave dhe kështu penguan punën e ministrive të caktuara, në dëm të qytetarëve, që në fund, si shumë herë më parë, kur erdhi koha e votimit, as nuk votuan kundër propozimeve që ata kritikuan aq shumë”, është thënë në reagimin e LSDM-së. Por, shumica është rritur me vetëm një deputet, pasi nga qeveria është larguar partia Alternativa për shkak të mosmarrëveshjes për ndarjen e posteve.

Debati për zgjedhjen e ministrave të rinj ka nisur më 13 shkurt dhe ka zgjatuar dy javë për shkak të bllokimeve me fjalime të gjata nga deputetët e VMRO DPMNE-së.

VMRO DPMNE-ja vlerëson se zgjerimi i shumicës është bërë

për “shpëtimin e qeverisë dhe jo për kursin evropian të vendit”. Shumica parlamentare synon ndryshimin e Kushtetutës maqedonase për përfshirjen e pakicës bullgare në preambulën e saj.

Një ndryshim i tillë është obligim që del nga marrëveshja e Shkupit me Sofjen për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve mes dy vendeve dhe zhblokimin e procesit të integritimit evropian të Maqedonisë së Veriut.

Për ta ndryshuar Kushtetutën, nevojiten dy të tretat e votave, apo 80 nga 120 vota të deputetëve, ndërkohë shumica tani ka vetëm 65.

Pa votat e partive opozitare, Alternativa, Besa dhe VMRO DPMNE, këto ndryshime nuk do të mund të miratohen, gjë që mund ta rrezikojë nisjen e bisedimeve të Shkupit për anëtarësim në Bashkimin Evropian, pasi Sofja sërish mund të bllokojë këtë proces.



“Wizz Air” pezullon fluturimet në Moldavi për arsye të sigurisë



BUDAPEST, 28 SHKURT - Kompania ajrore e Hungarisë, Wizz Air, do ta shmangë aeroportin në kryeqytetin moldav, Kishinjev, nga 14 marsi për arsye të sigurisë, ka thënë Autoriteti Civil i Aviacionit në Moldavi.

Ky autoritet ka thënë se është informuar nga kompania ajrore dhe se i vjen keq për marrjen e një vendimi të tillë.

Në njoftim është thënë, po ashtu, se Republika e Moldavisë është duke bërë

gjithçka për ta garantuar sigurinë e hapësirës së saj ajrore.

Ekzistojnë shqetësime se lufta e Rusisë në Ukrainë mund të përhapet edhe në Moldavinë fqinje.

Ushtarët rusë janë të stacionuar në rajonin e shkëputur të Transdnjestrit.

Javën e kaluar Rusia ka pretenduar se Ukraina dëshiron ta sulmojë këtë kontingjent të vogël të trupave ushtarake.

Pasi Kishinjevi nuk është më

destinacion për fluturime, “Wizz Air” synon të ofrojë më shumë fluturime nga qyteti rumun, Iasi, që gjendet afër kufirit, është thënë në disa raportime të medieve.

“Wizz Air” realizon fluturime në disa qytete në qendër dhe juglindje të Evropës.

Meqë i gjithë trafiku ajror në Ukrainë është pezulluar për shkak të luftës, aeroporti në Kishinjev është një nga destinacionet më të afërta për ukrainasit.

Kanadaja e ndalon përdorimin e TikTok-ut në pajisjet qeveritare

OTTAWA, 28 SHKURT - Kanadaja ka thënë se do ta ndalojë përdorimin e aplikacionit TikTok në të gjitha pajisjet qeveritare, duke nisur nga dita e martë. Ky vendim vjen pas një rishikimi që i kanë bërë këtij aplikacioni zyrtarë qeveritarë për informacion.

Qeveria kanadeze ka thënë përmes një deklarate se ky aplikacion “paraqet nivel të pashembullt të rrezikut për privatësinë dhe sigurinë”.


Përfaqësues të TikTok-ut kanë thënë se kompania është e zhgënjyer me këtë vendim.

Ky vendim vjen disa ditë pasi edhe Komisioni Evropian e ka prezantuar një ndalesë të

ngjashme.

Kryeministri kanadez, Justin Trudeau, ka thënë se ekzistojnë mjaftueshëm shqetësime për sigurinë e këtij aplikacioni. “Ky mund të jetë hapi i parë, ky mund të jetë hapi i vetëm që na duhet ta marrim”, ka thënë ai në një konferencë për medie në Toronto.

TikTok-u është kritikuar edhe në të kaluarën për përdorimin e informacionit personal dhe për lidhjet me qeverinë kineze. Ky aplikacion i formatit me video të shkurtra është në pronësi të kompanisë kineze, “ByteDance”. Punëtorëve federalë në Shtetet e



Bashkuara u është ndaluar përdorimi i TikTok-ut vitin e kaluar.

Shtëpia e Bardhë ka thënë më

27 shkurt se agjencitë qeveritare kanë 30 ditë kohë për ta fshirë aplikacionin nga të gjitha sistemet.

Edhe një numër i universiteteve amerikane e kanë ndaluar përdorimin e aplikacionit prej rrjeteve të veta.

Ndalesa më të mëdha publike janë zbatuar në Indi dhe në disa shtete aziatike.

Vetë zyrtarë të TikTok-ut insistojnë se qeveria kineze nuk ka qasje në të dhëna dhe se një version kinez i aplikacionit funksionon ndaras prej atij që përdoret në pjesën tjetër të botës. Megjithatë, ata e kanë pranuar vitin e kaluar se një pjesë e stafit në Kinë mund të ketë qasje në të dhënat e përdoruesve në Evropë.

Weber: Nëse nuk u pajtuan për Asociacionin, nuk patën marrëveshje

PRISHTINË, 28 SHKURT - Mungesa e një pajtimit të qartë në lidhje me Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë do të thotë se nuk pati ndonjë përparim në bisedimet midis kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, të mbajtura më 27 shkurt në Bruksel, thotë eksperti për Ballkanin, Bodo Weber, në një intervistë dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Dy udhëheqësit thanë se janë pajtuar me përmbajtjen e një propozimi të BE-së për normalizimin e marrëdhënieve, por nuk e nënshkruan atë. Propozimi i BE-së, i titulluar

marrëveshje drejt normalizimit Kosovë - Serbi, kërkon që palët t'i zbatojnë të gjitha marrëveshjet e arritura në kuadër të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë atë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, të cilin Kosova, deri më tash, ka refuzuar ta themelojë.

Zyrtarë të BE-së, që ndërmjetësuan bisedimet, paralajmëruan takime të reja midis Kurtit dhe Vuçiqit për modalitetet e zbatimit të Marrëveshjes.

Pikërisht kjo, sipas Weberit, bashkëpunëtor i lartë i Këshillit për Politikën e Demokratizimit në Berlin, është indikator se në

takimin e 27 shkurtit nuk kishte përparim drejt arritjes së një marrëveshjeje finale, "por vetëm shtyrje të mosmarrëveshjeve për t'u diskutuar me aneksin e zbatimit".

Në pyetjen se a e priste këtë rezultat dhe çfarë mendon për të, Weberi është përgjigjur: "Unë do të thosha dy gjëra... Së pari, për shkak të presionit të kryeqyteteve perëndimore - të përfshira në negociatën dhe që e mbështetin propozimin për Beogradin, aq më tepër për palën kosovare, nuk ishte e papritur që shefi i politikës së jashtme të BE-së, Joseph Borrell, deklaroi mbrëmë [se ka pasur] sukses. Dhe, së dyti, si çdo

gjë me këtë propozim dhe marrëveshje, që duket goxha e paqartë, edhe deklarimi [se ka pasur] progres, dukej shumë i paqartë. Ju mund ta kenë vërejtur se z. Borrelli nuk po fliste për arritjen e një marrëveshjeje, por thoshte se palët kanë rënë dakord të mos negociojnë më tej për marrëveshjen [drejt normalizimit Kosovë-Serbi], por t'i vazhdojnë negociatat për aneksin e zbatimit. Ndërsa nëse e dëgjoni deklaratën e presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, pas takimit - as që mund të dëgjohej [duke thënë] se është arritur marrëveshje".

Weberi ka thënë se është shumë e

vështirë të kesh vërtet besim se kjo marrëveshje e përkohshme do të nënkuptojë me të vërtetë një përparim të madh dhe përfundimisht do të çojë në një marrëveshje përfundimtare, e cila do ta përfshinte njohjen zyrtare ligjore të Kosovës nga Serbia. "Pra, pyetja është: [çfarë do të ndodhë] në rast se kjo nuk do të çojë në pikën përfundimtare të synuar?", ka theksuar Weberi. Sipas tij, nëse ky proces nuk do të çojë në një zgjidhje të qëndrueshme, atëherë patjetër do të jetë Beogradi ai që do të përfitojë në afat të gjatë, duke manovruar BE-në dhe ShBA-në në një afat më të gjatë.



Finlanda, më afër pranimit në NATO pa Suedinë

HELSINKI, 28 SHKURT - Finlanda të martën ka nisur debatin parlamentar që synon ta përshpejtojë rrugën e shtetit drejt pranimit në NATO dhe duke rritur gjasat ta vazhdojë këtë rrugë vetëm pa shtetin fqinj, Suedinë.

Finlanda, që ka një prej kufijve më të gjatë me Rusinë në Evropë dhe Suedia hoqën dorë nga politika dekadëshe e mosangazhimit ushtarak dhe aplikuan për anëtarësim në aleancën ushtarake perëndimore majin e kaluar, pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës. Por, për shkak se u përball me më pak pengesa diplomatike sesa Stokholmi, Helsinki duket se po lëviz drejt NATO-s edhe para zgjedhjeve të përgjithshme që do të mbahen në prill në Finlandë, teksa opinioni publik, po ashtu,

mbështet anëtarësimin në aleancë.

Të dy shtetet kanë marrë mbështetjen e 28 nga 30 shtetet anëtare të NATO-s. Vetëm Hungaria dhe Turqia ende nuk kanë ratifikuar pranimin e dy vendeve nordike në aleancën ushtarake.

Shumë deputetë finlandezë po kërkojnë të miratohet legjislacioni që Finlanda t'i pranojë kushtet e traktatit të NATO-s para zgjedhjeve të 2 prillit.

Debati parlamentar mbahet të martën, ndërkaq votimi pritet të ndodhë të mërkurën.

Kur të miratohet i gjithë legjislacioni i duhur, Finlanda mund të lëvizë më shpejt edhe nëse ratifikimet ndodhin para se qeveria e re të formohet. "Koha është tani për të ratifikuar dhe



për t'i mirëpritur plotësisht si anëtare Finlandën dhe Suedinë", tha shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë vizitës në këtë shtet të martën. "Mesazhi im për Finlandën dhe Suedinë është t'i përmbushin ato që kanë premtuar në marrëveshjen trepalëshe që arritën me Turqinë

qershorin e kaluar", shtoi ai. Helsinki ka theksuar se pëlqen t'i bashkohet aleancës së bashku me Suedinë, por miratimi i legjislacionit që pritet të miratohet pa problem në Parlamentin finlandez po shihet si sinjal se Finlanda është e gatshme të lëvizë drejt NATO-s e

vetme.

Turqia ka bllokuar pranimin e anëtarëve të rinj, veçmas të Suedisë, të cilën e akuzon se po strehon ata që Ankaraja i konsideron "terroristë", posaçërisht anëtarët e Partisë së Punëtorëve të Kurdistanit.

Megjithatë, më 27 shkurt kryediplomati i Turqisë, Mevlut Cavusoglu, tha se Turqia e sheh në mënyrë më favorizuese anëtarësimin e Finlandës në NATO. "Ne ndoshta duhet ta ndajmë procesin e anëtarësimit të Suedisë dhe Finlandës", tha ai. Përderisa miratimi i legjislacionit nga autoritetet finlandeze nuk nënkupton se shteti automatikisht do të anëtarësohet në NATO pas ratifikimeve nga Turqi dhe Hungari, por vendos afate kohore sesa mund të presë për fqinjën e saj.



Opozita e ndarë rreth pranimimit të propozimit evropian

Dy partitë më të mëdha opozitare në vend, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë kritikuar pranimin e propozimit evropian nga kryeministri Albin Kurti. Sipas këtyre dy partive, me këtë propozim për normalizimin e raporteve me Serbinë, Kosova ka humbur njohjen e ndërsjellë dhe ka pranuar ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Ndryshe nga PDK-ja dhe LDK-ja, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka përkrahur propozimin evropian

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 28 shkurt - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, kanë rënë dakord të hënën në Bruksel sa i përket propozimit të Bashkimit Evropian për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve. Në tryezën e bisedimeve ishte propozimi i BE-së, i titulluar "Marrëveshje drejt normalizimit mes Kosovës dhe Serbisë".

Në deklaratën e lëshuar pas takimit, shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, tha se palët shprehën gatishmërinë e tyre për ta vazhduar zbatimin e kësaj marrëveshje. "Nevojiten negociata të mëtejshme për t'i përcaktuar modalitetet specifike të zbatimit të dispozitave", ka theksuar Borrell, duke paralajmëruar takimin e radhës në mes të Kurtit dhe Vuçiqit në

muajin mars.

Propozim-marrëveshja që u bë publike pas takimit, përfshin zotimin e palëve për t'i respektuar të gjitha marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve si dhe përkushtimin e tyre për të mos e penguar njëra-tjetrën në proceset integruese. Marrëveshjet e deritashme përfshijnë edhe atë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, e cila është arritur në vitin 2013, por nuk është zbatuar kurrë. Pas takimit, Kurti konfirmoi se palët kanë rënë dakord për përmbajtjen e propozimit evropian. "Ishte konfirmim që propozimi evropian është i pranueshëm dhe i pandryshueshëm. Ecja përpara do të jetë për planin e zbatimit. Jemi në një rrugë të mbarë dhe njëkahëshe të normalizimit të marrëdhënieve.

Është marrëveshje e simetrisë, e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit në të ardhmen. Unë nuk kam nënshkruar, sepse pala tjetër nuk ishte e gatshme për të nënshkruar. Unë mendoj se është dëm që nuk është nënshkruar sonte, meqenëse u pajtuam", ka thënë Kurti.

Sa i përket gatishmërisë së tij për ta zbatuar Marrëveshjen për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, Kurti tha se për këtë ka folur më herët. "Ai është neni 10, është fjalë e fundit e praktikisht nenit të fundit dhe për këtë gjë tash jam përgjigjur", ka thënë Kurti për gazetaret në Bruksel.

Dy partitë më të mëdha opozitare në Kosovë, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Kosovës, kanë kritikuar pranimin e propozimit evropian nga kryeministri Albin Kurti. Sipas këtyre dy partive, me këtë propozim për normalizimin e raporteve me Serbinë, Kosova ka humbur njohjen e ndërsjellë dhe ka pranuar që ta themelojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Ajo që kishim paralajmëruar edhe ndodhi. Kushtet dhe qëndrimet u shkrinë para interesave personale dhe ambicieve për pushtet të kryeministrit Kurti. Kosova humbi njohjen dhe fitoi Asociacionin. Duhet thënë zëshëm dhe qartë: tashmë është

edhe zyrtarisht evidente se propozimi evropian nuk parasheh njohjen e ndërsjellë si kriter kryesor për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe hapjen e perspektivës evropiane për shtetit tonë", ka thënë lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.

Sipas tij, aty nuk flitet për njohjen nga pesë vendet mosnjohëse të BE-së, nuk flitet për hapjen e rrugës drejt anëtarësimit në NATO, as për marrjen e statusit kandidat për anëtarësim në BE. "Për dy vjet me radhë ne e kemi mbështetur kryeministrin Kurti në raport me Serbinë. E kemi inkurajuar të koordinohet me aleatët tanë ndërkombëtarë dhe i kemi ofruar edhe propozime konkrete në lidhje me marrëveshjen finale me njohjen e ndërsjellë në qendër. Duke e injoruar çdo ndihmë e këshillë që ka ardhur nga ne, kokë në vete dhe në kundërshtim me interesat afatgjatë të Republikës së Kosovës, kryeministri Kurti, përmes veprimeve dhe politikave të gabuara, degradoi pakthyeshëm procesin e dialogut. Rrjedhimisht, ai mundësoi heqjen e marrëveshjes finale me njohjen e ndërsjellë në qendër dhe i solli vendit një marrëveshje të përkohshme me asociacionin në qendër", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se, krahas

rritjes enorme të emigrimit si pasojë e keqveerisjes, kryeministri Kurti tkurri edhe sovranitetin e shtetit tonë. "Prandaj, 27 shkurti i vitit 2023, për Kosovën, me kryeministër Albin Kurtin, shënon një mundësi të humbur për shtetin tonë që ta përmbyllë përgjithmonë konfliktin e ngrirë me Serbinë", ka thënë Krasniqi. Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka reaguar në lidhje me propozimin evropian. "Nga deklarimi i kryeministrit mbi këtë marrëveshje tashmë të dakorduar, por ende të paprezantuar në Kuvendin e Kosovës, u vërtetuan brengat e LDK-së, të bëra tashmë publike. Kjo marrëveshje nuk është finale dhe nuk e përmban njohjen e ndërsjellë. Për më tepër ajo mban ambiguitet interpretues mbi statusin politik të dy shteteve. Gjithçka përveç njohjes - ishte qëllimi i Serbisë. Gjithçka përveç njohjes ka kjo marrëveshje sot, tashmë e pranuar nga palët", ka njoftuar LDK-ja.

Sipas LDK-së, dokumenti i pranuar po ashtu parasheh implementimin e të gjitha marrëveshjeve paraprake përfshirë dhe Asociacionin si dhe statusin e veçantë për Kishën Ortodokse Serbe. "Kryeministrit i ka mbetur vetëm ta dakordojë datën e themelimit të Asociacionit,

meqë ai, me pranimin e zbatimit të marrëveshjeve paraprake, ka pranuar që ta themelojë atë. LDK konsideron se menaxhimi tërësisht i gabuar i procesit të dialogut nga kryeministri i Kosovës përgjatë dy vjetëve të fundit ka zhvendosur procesin e dialogut nga një marrëveshje përfundimtare e ligjërish të obligueshme në një marrëveshje bazë, pa njohje në të dhe me vazhdimësi dialoguese për vitet e ardhshme. Përfundimi në mes të zgjedhjes së një marrëveshje të tillë dhe izolimit eventual të Kosovës janë përgjegjësi e këtij kryeministri”, është thënë në njoftimin e LDK-së.

Ndryshe nga PDK-ja dhe LDK-ja, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, e ka përkrahur Kurtin në pajtimin që ka dhënë në Bruksel për propozimin evropian. Haradinaj ka theksuar se pajtimi për ta pranuar propozimin evropian për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi është një e arritur e madhe. “Marrëveshja është pranimit faktik i pavarësisë së Kosovës, e cila i rikthehet normalitetit politik e të sigurisë, perspektivës integruese euroatlantike e njohjeve të reja. Po aq e rëndësishme mbetet edhe faza vijuese e bisedimeve për çështje të tjera të hapura, për të cilat dua të besoj se do të gjenden zgjidhjet më të mira, me çka do të përmbillet edhe kapitulli i njohjes ‘de jure’ midis Kosovës dhe Serbisë”, ka deklaruar Haradinaj.

Propozim-marrëveshja

Bashkimi Evropian më 27 shkurt publikoi të plotë tekstin e propozimit evropian për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë. Teksti u publikua pas raundit të dialogut, ku palët u pajtuan për këtë propozim.

Palët kontraktuese:

Të përkushtuara për të kontribuar në bashkëpunimin dhe sigurinë e frytshme rajonale dhe për të kapërcyer trashëgimin e së kaluarës; Të vetëdijshme për përgjegjësinë e tyre për ruajtjen e paqes; Të përkushtuara të kontribuojnë në sigurinë dhe bashkëpunimin e frytshëm rajonal në Evropë; Të vetëdijshëm për paprekshmërinë e kufijve dhe respektimit të integritetit dhe sovranitetit territorial, si dhe mbrojtja e pakicave kombëtare, janë kushtet themelore për paqen; Duke vepruar nga fakti historik dhe pa paragjykuar pozicionet e ndryshme të palëve në lidhje me çështjet themelore, përfshirë çështjen e statusit;

Me dëshirën për të krijuar kushte për bashkëpunim midis palëve për të mirën e njerëzve, kanë rënë dakord që:

Neni 1

Palët do të zhvillojnë marrëdhënie normale të

fqinjësisë së mirë me njëra-tjetrën, mbi bazën e të drejtave të barabarta.

Të dyja palët do t'i njohin dokumentet relevante dhe simbolet kombëtare të njëra-tjetrës, përfshirë pasaportat, diplomatat, targat e automjeteve dhe vlatat doganore.

Neni 2

Të dyja palët do të udhëzohen nga qëllimi dhe parimet e përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me të drejtat sovraane të shteteve, respektimin e pavarësisë, autonomisë dhe integritetit territorial të tyre, të drejtën për vetëvendosje, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimin.

Neni 3

Në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara, palët do ta zgjidhin çdo mosmarrëveshje ndërmjet tyre vetëm në mënyrë paqësore dhe do të përmbahen nga kërcënimi apo përdorimi i forcës.

Neni 4

Palët nisen nga supozimi se asnjëra nga këto të dyja nuk mund ta përfaqësojë palën tjetër në sferën ndërkombëtare apo të veprojnë në emër të saj. Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare.

Neni 5

Asnjëra palë nuk do të bllokojë, ose do të inkurajojë të tjerët të bllokojnë përparimin e palëve në

rrugët e tyre perspektive drejt BE-së bazuar në meritat e tyre. Të dyja palët duhet të respektojnë vlerat e përmendura në nenin 2 dhe 21 të Traktatit të Bashkimit Evropian.

Neni 6

Përderisa kjo marrëveshje bazë përfaqëson një hap të rëndësishëm të normalizimit, të dyja palët do të vazhdojnë me një shtysë të re në procesin e dialogut të udhëhequr nga BE-ja, që do të çojë në marrëveshjen ligjërish të detyrueshme, gjithëpërfshirëse për normalizimin e marrëdhënieve.

Palët bien dakord ta thellojnë bashkëpunimin në të ardhmen në fushat e ekonomisë, shkencës dhe teknologjisë, transportit dhe lidhshmërisë, marrëdhënieve në drejtësi dhe zbatim të ligjit, postë dhe telekomunikacion, shëndetësi, kulturë, fe, sport, mbrojtje të mjedisit, persona të zhdukur, dhe fusha të tjera të ngjashme përmes arritjes së marrëveshjeve specifike. Detajet do të pajtohen në marrëveshjet shtesë në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja.

Neni 7

Të dyja palët janë të përkushtuara në arritjen e marrëveshjeve specifike dhe garancive, në përputhje me instrumentet përkatëse të Këshillit të Evropës dhe duke përdorur përvojat ekzistuese evropiane, për të siguruar një nivel të përshtatshëm të vetëqeverisjes për komunitetin serb në Kosovë dhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve në disa fusha specifike, përfshirë

mundësinë e ndihmës financiare nga Serbia dhe kanalet e drejtpërdrejta të komunikimit të komunitetit serb me Qeverinë e Kosovës.

Palët do ta zyrtarizojnë statusin e Kishës Ortodokse Serbe në Kosovë dhe do të ofrojnë një nivel të lartë të mbrojtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore serbe, në përputhje me modelet ekzistuese evropiane.

Neni 8

Palët do të shkëmbejnë misionet të përhershme. Ato do të vendosen në selitë përkatëse të qeverive. Çështjet praktike që lidhen me vendosjen e misioneve do të trajtohen veçmas.

Neni 9

Të dyja palët vënë në dukje angazhimin e BE-së dhe donatorëve të tjerë për ta krijuar një pako të veçantë ndihme financiare për projektet e përbashkëta të palëve për zhvillimin ekonomik, lidhshmërinë, tranzicionin e gjelbër dhe në fusha të tjera kyçe.

Neni 10

Palët do ta krijojnë komisionin e përbashkët, të kryesuar nga BE-ja, për monitorimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Të dyja palët konfirmojnë detyrimet e tyre për zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të dialogut nga e kaluara.

Neni 11

Palët angazhohen të respektojnë udhërrëfyesin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Bislimi përmend tri kushte për formimin e Asociacionit

PRISHTINË, 28 SHKURT - Kryenegociatori i Kosovës në dialogun me Serbinë, Besnik Bislimi, i ka thënë të martën Parlamentit Evropian në Bruksel se ekzistojnë tri kushte kryesore për formim të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. “Asociacioni duhet të jetë në përputhje me ligjet e Kosovës, duhet të jetë në përputhje me qëndrimet e BE-së se nuk mund të ketë fuqi ekzekutive, siç është thënë në letrën që ish-përfaqësuesja e Lartë, Federica Mogherini, ia kishte dërguar atëbotë kryeministrit të Kosovës. Së treti, që Asociacioni të mos paraqesë nivelin e tretë të pushtetit”. Ai ka thënë se, sipas ligjeve të Kosovës, nuk mund të ekzistojë autonomi territoriale e serbëve në Kosovë. Bislimi ka përmendur se 60 për qind e serbëve në Kosovë jetojnë jashtë pjesës veriore të vendit. Bislimi e ka përmendur Asociacionin kur e ka diskutuar marrëveshjen drejt normalizimit të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë, për të cilën është arritur pajtueshmëri të hënën në Bruksel në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin

Kurti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Ai ka thënë se marrëveshja e përfshin edhe një pikë që parashihet zbatimin e marrëveshjeve të arritura në të kaluarën në dialog, por që ajo duhet të sqarohet. “Ky paragraf duhet të detajohet. Së pari të bëjmë një analizë të marrëveshjeve nga e kaluara. Sepse nuk ka kuptim të diskutohet për disa marrëveshje që janë tejkualuar dhe të cilat tash zgjidhen me marrëveshjen e fundit. Si për shembull marrëveshjet për njohjen e vulave, kadastrat e tjera, nëse me këtë marrëveshje njihen të gjitha dokumentet. Pra, duhet të shohim se cilat marrëveshja janë akoma të vlefshme e cilat janë tejkualuar tashmë”, ka thënë ai. Në debatin e zhvilluar në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, shumica e eurodeputetëve e kanë përshëndetur arritjen e pajtueshmërisë në mes të Kosovës dhe Serbisë më 27 shkurt.

Bislimi ka thënë se tani fokusi mbetet të darkodimi për planin për zbatimin e marrëveshjes. “Ajo për çfarë u pajtuam është se



nuk do të diskutohet më propozimi, por do të fokusohemi në pjesën e dytë, që është edhe më e rëndësishme, sepse ka të bëjë me implementimin. Duhet ta fokusojmë energjinë që ta dizajnojmë planin për t'i shmangur paqartësitë si dhe për

t'i sqaruar obligimet e të gjitha palëve që dalin nga kjo marrëveshje si dhe sekuencimin e aktiviteteve që do të pasojnë. Duhet të caktohen edhe afatet kohore dhe modalitetet e monitorimit të zbatimit”, ka thënë Bislimi teksa u është

përgjigjur deputetëve. “Vetëm plani i duhur i zbatimit do të sigurojë se kjo nuk do të mbetet vetëm një nga 34 marrëveshjet që janë arritur deri më tash, por ajo do të krijojë një ndryshim pozitiv në raporte”, ka thënë Bislimi.

Kosova me sovranitet post-Westphalian



Dr. Sc. Salihe SALIHU

Marrëveshja franko-gjermane për Kosovën dhe Serbinë, e paraqitur më 27.02.2023

në Bruksel, ka nxjerrë në pah edhe modelin e sovranitetit të shteteve dhe ky model i paraqitur dje përkon me qasje të sovranitetit post-Westphaliane. Rrjedhimisht, shihet më hollësisht që sovraniteti post-Westphalian nuk është i ngjashëm me modelin klasik të sovranitetit ashtu siç shumica kanë pritur dhe kanë ëndërruar apo dëshiruar.

Çfarë sovraniteti është përfshirë në marrëveshje?

Model i ri i sovranitetit post-Westphaliane ka ndryshuar përmbajtjen e konceptit të sovranitetit klasik meqë ky model i ri i sovranitetit ka kufizuar sovranitetin përmes obligimeve që shtrohen nga rendi ndërkombëtar. Obligimet që janë pjesë e transformimit të modelit të sovranitetit janë qenësore për ekzistimin e çdo shteti sovran në këtë epokë globale. Transformimi i attributeve të përmbajtjes së konceptit klasik të sovranitetit në konceptin post-Westphalian në mënyrë decisive janë të përcaktuara në çështjet që lidhen me të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale që janë specifika të veçanta në konventat ndërkombëtare në rendin ndërkombëtar botëror.

Transformimin e këtyre attributeve të konceptit të sovranitetit e gjejmë edhe në marrëveshjen Kosovë - Serbi në të cilën përfshihen 11 pika të cilat paraprihen nga preambula që definojnë në mënyrë deterministe edhe orientim e qëllimit për ruajtjen e paqes mes të dy palëve, përkatësisht dy shteteve, nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Me pikat e marrëveshjes që tani janë të njohura edhe për opinionin vendor dhe ndërkombëtar është qartësuar se çfarë modeli të sovranitetit ka Kosova. Korniza e marrëveshjes së djeshme ka të përfshirë sovranitet të garantuar ndërkombëtarisht. Në anën tjetër, kufizimi i sovranitetit, që është model post-Westphalian, është në korrespondencë të realitetit dhe me inkorporimin e referencave nga Konventat Ndërkombëtare, duke përfshirë drejtësinë, barazinë, mbrojtjen e konfeksioneve religjioze, të drejtat e minoriteteve,

si dhe pavarësinë reciproke mes relacioneve ndërshtetërore. Për Kosovën dhe Serbinë ky model i sovranitetit hap mundësinë për vazhdimin e procesit të integritetit dhe zgjedhjen e problemeve ekzistuese mes dy vendeve në mbikëqyrje apo monitorim ndërkombëtar. Ky model i sovranitetit post-Westphalian, padyshim se do të përballet me stuhi të vazhdueshme që do të shfaqen në periudhën pas nënshkrimit të kësaj ujdje mes palëve. Të gjitha pikat e Marrëveshjes janë me nivel të lartë të sensitivitetit gjatë implementimit dhe nevojitet vërtet që mbikëqyrja të jetë jashtëzakonisht rigoroz dhe me vigjilencë të lartë analitike gjatë periudhës kur të procedohet ky dokument. Problemi crucial që në të ardhmen mund të përballet ky dokument i marrëveshjes është që të mos lejohet devijimi i përmbajtjes gjatë

implementimit të tij. Në veçanti, pala kosovare duhet të jetë edhe më rigoroz gjatë implementimit dhe të mos vetëkënaqet vetëm me nënshkrimin e këtij dokumenti. Skepticizmin për qëndrueshmërinë e këtij dokumenti të marrëveshjes duhet ta mposhtim me besim në vetvete dhe me bindjen tonë se e ardhmja jonë është e kushtëzuar me raporte të mira fqinjësore. Serbia duhet të vetëdijësohet njëherë e përgjithmonë se rrugë tjetër nuk ekziston dhe dokumenti i marrëveshjes është në interes të të dyja palëve. Nëse dy palë kanë vullnet të mirë për tërësinë e implementimit të këtij dokumenti të marrëveshjes atëherë mund ta konsiderojmë si një busull e partneritetit paqësor mes dy shteteve që do të ndikonte pozitivisht në rajon dhe në Evropë, duke siguruar paqe të qëndrueshme.

25 vjet nga fillimi i luftës në Kosovë

Dita e sotme (e martë, 28 shkurt) shënon 25-vjetorin e fillimit të luftës në Kosovë. Ajo nisi në fshatrat Likoshan e Qirez të Drenicës, ku, me urdhër të Millosheviqit, filloi ofensiva e madhe e forcave serbe. Në betejën e hapur në mes të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave serbe, të cilat e përdorën edhe artilerinë e rëndë, mbetën të vrarë disa pjesëtarë të tyre. Si pasojë e kësaj, forcat serbe rrethuan këto dy fshatra ku i ekzekutuan 24 civilë shqiptarë. Kjo masakër, njihet si e para ndaj civilëve shqiptarë e kryer nga forcat serbe gjatë luftës në Kosovë. Zhvendosja e luftës nga ana e Serbisë, nga lufta kundër UÇK-së, në luftë kundër popullatës civile shqiptare, shënon fillimin e zbatimit të projektit shtetëror serb të gjenocidit kundër shqiptarëve në Kosovë. Gjatë periudhës kohore shkurt 1998-qershor 1999, sa zgjati lufta në Kosovë, forcat serbe dëbuan më dhunë afër një milion shqiptarë, vranë mbi 15 000 civilë - pleq, burra, gra dhe fëmijë, 2 400 prej tyre pjesëtarë të UÇK-së. Në këtë periudhë kohore forcat serbe kanë përdhunuar afër 20 mijë femra shqiptare, kanë shkatërruar dhe djegur pjesërisht ose tërësisht rreth 1 100 vendbanime shqiptare, kanë plaçkitur, djegur e shkatërruar mbi 200 000 shtëpi, banesa, lokale afariste, punëtori zejtare, fabrika, shkolla, biblioteka, monumente kulturore-historike, objekte kulturore, shkencore, fetare etj. Gjatë luftës ato kanë burgosur mbi 1 360 veta, ndërsa zhdukën rreth 5 000 të tjerë. Kjo luftë, që filloi më 28 shkurt 1998, ka zgjatur deri më 10 qershor 1999, është zhvilluar mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave ushtarake dhe policore serbe. Ndërsa nga 24 marsi 1999 deri më 10 qershor 1999 në të ka qenë e përfshirë edhe NATO përmes sulmeve ajrore mbi caqet ushtarake serbe. Për pasojë, Slobodan Millosheviqi u detyrua ta nënshkruajë kapitullimin e Serbisë në Kosovë më 9 qershor 1999 në Kumanovë.

(Lulëzim ETEMA)



KMDLNj: Shtrenjtimi i rrymës përkeqëson gjendjen ekonomike të shumicës së qytetarëve



PRISHTINË, 28 SHKURT - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka vlerësuar se shtrenjtimi i rrymës përkeqëson gjendjen ekonomike të shumicës së qytetarëve të Kosovës. "Operatori i vetëm në Kosovë për furnizim me energji elektrike i ka bërë kërkesë ZRR-së për shtrenjtimin e energjisë elektrike diku mbi 54 për qind, kurse ZRR-ja në vend se t'i mbrojë interesat e qytetarëve të Kosovës që me vështirësi po i shlyejnë faturat me çmime ekzistuese, të lehtësuara nga subvencionimi i Qeverisë së Kosovës, krahasuar me më herët, është treguar më i mëshirshëm duke lejuar shtrenjtimin vetëm me 13.4 për qind që, krahasuar me shumën e kërkuar, duket, në shikim të parë, si një përfitim apo subvencion shtesë për qytetarët e Kosovës. Në të njëjtën kohë, Qeveria e Kosovës, duke u mbështetur në 'praktikat e mira' të qeverive të mëparshme, ka vazhduar t'ua paguajë rrymën serbëve (dhe të tjerëve) në veriun e Kosovës duke e zbatuar skajshmërisht të deformuar parimin e diskriminimit pozitiv", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas KMDLNj-së, vetëm për vitin 2022 Qeveria e Kosovës, për t'i qetësuar serbët e veriut të Kosovës e në kurriz të kësaj kanë përfituar edhe të tjerët, ka ndarë 63 milionë euro për pagesën e faturave për energji elektrike që e

kanë shfrytëzuar dhe keqpërdorur, pa asnjë masë kufizimi, për dallim nga pagesit e rregullt të faturave poshtë lumit Ibër që u janë nënshtruar reduktive dhe prishjeve të shumta. "Qeveria aktuale e Kosovës ka fituar vota me premtime të forta dhe të pakundërshtueshme se më nuk do ta paguajë rrymën për serbët e veriut të Kosovës duke sulmuar qeveritë paraprake për këtë. Duket se ka një marrëveshje politike që detyron Qeverinë e Kosovës t'i mbulojë shpenzimet për rrymën e keqpërdorur në veri të Kosovës, pandershem dhe pamëshirshëm nga qytetarët sikur, sidomos nga krimi i organizuar për prodhimin e kriptoalutave dhe bimëve narkotike", thuhet në reagim.

Më tej theksohet se veprimi i qeverisë(ve) që diskriminon qytetarët ekskluzivisht në baza etnike është në kundërshtim të plotë me ligjin, me të drejtat e njeriut dhe frymën kushtetuese që garanton mbrojtje nga çdo diskriminim. "Qeveria e Kosovës po e bën pikërisht të kundërtën, po e përllig një diskriminim me arsytetime politike dhe duke sulmuar qeveritë paraprake. Në kohën kur pjesa më e madhe e qytetarëve të Kosovës pret me ankth çdo rritje të çmimit të energjisë elektrike për faktin se për shkak të inflacionit galopant dhe rritjes tej mase të çmimit të artikujve të domosdoshëm të

shportës familjare, qytetarëve në veri të Kosovës nuk iu bënë fare përshtypje edhe nëse çmimet e rrymës rriten edhe 500 për qind; asgjë nuk paguajnë, asnjë cent të vetëm dhe gëzohen me problemet me të cilat përballen të tjerët. Në kohën kur KEDS-i për 10 minuta të vonësës së shlyerjes së faturës, në mënyrë automatike të shkyçë nga rrjeti i furnizimit dhe përrikycje duhet të paguani para shtesë, serbëve në veri nuk guxon askush t'ua lexojë njehsorët e rrymës e që janë vendosur nga Elektroserbia që këtë pjesë të Kosovës e trajton sikur të ishte pjesë e Serbisë. Operatori i licencuar nga Artane Rizvanolli, 'Elektrosever', aspak nuk dallon nga 'Elektroserbia'. Është pjesë operative e saj. Me asgjë dhe për asgjë nuk iu përgjigjet institucioneve të Kosovës, theksohet në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka theksuar se kupton dhe përkrah çdo vendim që qytetarët e Kosovës të ndihmohen nga Qeveria e Kosovës, qoftë pjesërisht apo edhe përmes shlyerjes së borxheve të grumbulluara që nga përfundimi i luftës, jo sipas parimit etnik, por sipas gjendjes ekonomike që e kanë. "Në KMDLNj ka raste kur familje skajshmërisht të varfra, për shkak të pamundësisë së shlyerjes së borxheve të grumbulluara, që nga përfundimi i luftës ua ndërprejnë furnizimin me rrymë

duke i kthyer në epokën e gurit. Më herët i dërgonin nëpër gjykata kurse tani i kanë lënë në mëshirën e përmbauesve duke ua marrë borxhin edhe nga pensionet apo të ardhurat minimale që i kanë e që, e njëjta gjë nuk ndodhë në veri të Kosovës. Nëse Qeveria e Kosovës ua shlyen të gjitha borxhet për rrymë, që nga përfundimi i luftës e deri më sot serbëve dhe të tjerëve në veri të Kosovës (deri vonë edhe në lokacionet tjera ku jetojnë serbët në Kosovë) pse atëherë nuk paska mundësi të bëjë një falje të pjesshme apo të krejt borxhit për familjet që, as nuk kanë pasur mundësi t'i shlyejnë borxhet dhe që, as tani nuk e kanë asnjë mundësi të bëjnë këtë?! Qeveria duhet të jetë e mëshirshme ndaj kategorive të rrezikuara sociale dhe të jetë e pamëshirshme ndaj atyre që kanë mundësi t'i paguajnë borxhet, që shpërdorojnë rrymën të cilën nuk e paguajnë, ta përdorin rrymën për veprimtari kriminale, vetëm për ta ruajtur dhe blerë një qetësi dhe lojalitet politik të cilin, as nuk e kanë pasur e as që do ta kenë", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Sipas këtij institucioni, rritja eventuale e energjisë elektrike sipas rekomandimeve dhe lejes së kusarëve të ZRRE-së, në mënyrë zinxhirore do të rrisë çmimet e artikujve të domosdoshëm dhe shërbimeve që pashmangshëm do të ndikojë

në varfërimin e mëtutjeshëm të qytetarëve të Kosovës. "Rritja e pamëshirshme, e papërgjegjshme dhe e pamoralshme e tatimit në pronë në masën mbi 100 për qind, nga persona të papërgjegjshëm, ka qenë atentat mbi ekonominë familjare. Paralajmërimi i rritjes së çmimit për mbledhje të plehrave është ngarkesë shtesë ndonëse KMDLNj mendon se këto shërbime ishin shumë të lira dhe e pamundësojnë punën e kompanive të pastrimit. KMDLNj dënon këtë trajtim të pabarabartë dhe diskriminues të qytetarëve të Kosovës, në baza ekskluzivisht etnike për faturat e energjisë elektrike dhe rikujton Qeverinë e Kosovës se, me këtë veprim apo mosveprim, në mënyrë flagrante po ua shkelë të drejtat e njeriut të pjesës dërrmuese të qytetarëve të Kosovës që e ka bërë të ditur edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës", thuhet në këtë reagim.

Sipas KMDLNj-së, fati që Kosova nuk është anëtare e Këshillit të Evropës për faktin se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për trajtim diskriminues të qytetarëve në baza, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut do ta penalizonte rëndë Kosovën duke detyruar që të kompensojë qytetarët e Kosovës për plaçkitjen flagrante përmes fryrjes së faturave me të cilat janë mbuluar faturat për serbët në veri të Kosovës dhe në lokacionet tjera.

UNDP publikon raportin mbi sfidat dhe mundësitë në kalimin në një ekonomi neutrale ndaj karbonit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 28 SHKURT - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka lansuar analizën e pulsit publik të titulluar "Eksplorimi i sfidave të ndryshimeve klimatike dhe mundësive për kalimin në ekonomi neutrale të karbonit në Kosovë". Ky publikim ofron njohuri dhe kontribute në diskutimin se si mund të ndikojë tranzicioni i gjelbër në ekonominë e Kosovës, cilët sektorë pritet të ndikohen dhe si do të ndikohet kërkesa për fuqi punëtore.

Ngjarja mbledhi në një vend përfaqësues nga institucionet e Kosovës, ekspertë dhe aktivistë të mjedisit, përfaqësues të shoqërisë civile, sektorit privat, rrethit akademik dhe partnerë zhvillimorë.

Me këtë rast u ofrua një mundësi për t'i prezantuar gjetjet dhe për të diskutuar për çështjet që kanë të bëjnë me ekonominë qarkore dhe tranzicionin drejt një ekonomie neutrale ndaj karbonit në Kosovë.

Analiza "Eksplorimi i sfidave të ndryshimeve klimatike dhe mundësive për kalimin në

ekonomi neutrale të karbonit në Kosovë" shqyrton perspektivat e institucioneve qendrore të Kosovës, bizneseve, organizatave të shoqërisë civile dhe publikut të gjerë. Raporti, gjithashtu, ofron detaje mbi njohuritë dhe qëndrimet e njerëzve ndaj ndryshimeve klimatike dhe dekarbonizimit.

Raporti vë në pah se 63 për qind e të anketuarve kishin dëgjuar për ndryshimet klimatike, ku të rinjtë (18-24) ishin më të vetëdijshëm me 70 për qind.

Në përgjithësi, televizioni ishte burimi kryesor i informacionit për të gjithë të anketuarit (65 për qind), i ndjekur nga mediet sociale (27 për qind). Përdorimi i energjisë së rinovueshme u rendit si zgjidhja e dytë më e mirë për t'i zbutur ndryshimet klimatike, duke sugjeruar se publiku është i vetëdijshëm për kontributin e lëndëve djegëse fosile në ndryshimet klimatike. Megjithatë, vetëm një pakicë (31 për qind) e të gjithë të anketuarve janë të gatshëm të paguajnë tarifa më të larta të energjisë elektrike për t'i zvogëluar ndikimet e ndryshimeve klimatike për gjeneratat e ardhshme, ndërsa



65 për qind e të anketuarve thanë se nuk do të paguanin tarifa më të larta të energjisë elektrike.

Përmbledhja e politikave "Ekonomia qarkore dhe tregu i punës", e paraqitur në të njëjtën ngjarje, thekson nevojën e kalimit në një ekonomi të gjelbër dhe rëndësinë për ta bërë këtë me zgjuarsi. Aty identifikohen

sektorët me potencialin më të madh për tranzicion ndërmjet ekonomive tradicionale dhe atyre qarkore në Kosovë, duke hedhur dritë mbi potencialin për ndryshim në numrin e punësimeve, aftësimin dhe përbërjen e vendeve të punës në pesë sektorë kyç vijues: menaxhimi i mbeturinave, bujqësia, prodhimi i ushqimit, pylltaria, ndërtimi dhe energjia.

Për më tepër, përmbledhja thekson implikimet për tregun e punës si në nivel të Kosovës ashtu edhe në sektorë të veçantë.

Projekti pulsi publik financohet bujarisht nga populli amerikan përmes USAID-it. Projekti rritja përmes rimëkëmbjes së gjelbër dhe të drejtë nga Covid-19 mbështetet nga Qeveria e Japonisë.

Ministria e Bujqësisë hap periudhën për aplikim për subvencione për vitin 2023

PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i ka njoftuar fermerët se e ka hapur periudhën për aplikim në programin për pagesa direkte - subvencione për vitin 2023.

Fermerët/aplikuesit, që përfitojnë subvencionin për sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellë/kultivuar, njëkohësisht do të përfitojnë edhe nga subvencionimi i pjesshëm i çmimit të naftës për litër, në vlerë prej 0.36 eurosh/litër për sasinë e naftës prej 150 l/ha e cila është e nevojshme për kultivimin e 1 ha të tokës bujqësore dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore që pranohen për subvencionim dhe që janë të parapara për t'u subvencionuar në këtë program.

Gjithashtu, fermerët/aplikuesit, që përfitojnë subvencionin për sipërfaqet e tokës bujqësore të



mbjellë/kultivuar me kulturat bujqësore: grurë, grurë për prodhimin e farës, misër, luledielli, patate dhe fasule

monokulturë, njëkohësisht do të përfitojnë edhe nga subvencionimi i pjesshëm për sasinë e plehut artificial të

shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit, në vlerë prej 150 eurosh/ha për grurë dhe grurë për prodhimin e farës, ndërsa

në vlerë prej 100 eurosh/ha për misër, luledielli, patate dhe fasule monokulturë dhe është vlerë shtesë mbi subvencionimin bazë për të gjitha sipërfaqet e tokës bujqësore të mbjellë/kultivuar, me kulturat bujqësore: grurë, grurë për prodhimin e farës, misër, luledielli, patate dhe fasule monokulturë, të cilat pranohen për subvencionim dhe që janë të parapara për t'u subvencionuar në këtë program. "Fermerët/aplikuesit, që përfitojnë subvencionimin e pjesshëm për sasinë e plehut artificial të shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit të grurit, grurit për prodhimin e farës, misrit, lulediellit, patates dhe fasules monokulturë, duhet të sjellin si dëshmi faturat e blerjes të sasisë së plehut artificial të shpenzuar/përdorur gjatë kultivimit, nga data 15.08 deri 15.09.2023", ka njoftuar Ministria e Bujqësisë.

Policia parandalon kontrabandë të mallrave nga Maqedonia e Veriut

PRISHTINË, 28 SHKURT - Policia kufitare e Kosovës, konkretisht njësitë task-forcë, më 27 shkurt, rreth orës 19:50, në Mjak të Vitisë ka ndaluar automjetin

transportues me targa vendore të cilin e drejtonte i dyshuari mashkull. "Gjatë kontrollit të automjetit nga autoritetet janë gjetur dhe konfiskuar një sasi e

filterëve të cigareve (128 pako x 10 000 filtera për pako), gjithsej (1,280,000 - një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë copë filtër) për të cilat i dyshuari nuk

kishte dokumentacion të rregullt. Me vendim të prokurorit rasti është iniciuar në procedurë të rregullt", ka njoftuar Policia e Kosovës.



Revolucion intelektual? Çfarë mendon Henry Kissingeri për ChatGPT?



Nga Henry KISSINGER, Eric SCHMIDT & Daniel HUTTENLOCHER

Një teknologji e re po përpiqet ta transformojë rrënjësisht procesin njohës tek njerëzit, që nga koha e shpikjes së shtypshkronjës. Teknologjia që shtypi Biblën e Gutenbergut në vitin 1455 e bëri mendimin abstrakt njerëzor më të komunikueshëm dhe me të shpejtë.

Por teknologjia e re po e ndryshon atë proces. Ndërsa shtypshkronja prodhoi një bollëk të mendimit njerëzor modern, teknologjia e re po arrin distilimin dhe përpunimin e tij. Në këtë proces, ajo po krijon një hendek midis njohurive njerëzore dhe të kuptuarit njerëzor.

Në rast se dëshirojmë që ta kalojmë me sukses këtë transformim, duhet të zhvillojmë disa koncepte të reja të mendimit njerëzor dhe ndërveprimit me makineritë. Kjo është sfida thelbësore e Epokës së Inteligjencës Artificiale. Teknologjia e re njihet si Inteligjenca Artificiale Gjeneruese; GPT do të thotë Transformimi Gjenerativ i Trajnuar Paraprakisht. ChatGPT, i zhvilluar në laboratorin kërkimor OpenAI, është tashmë në gjendje të bisedojë me njerëzit. Ndërsa kapacitetet e tij po bëhen gjithnjë e më të gjera, ato do të ripërcaktojnë njohuritë njerëzore, do të përshpejtojnë ndryshimet në strukturën e realitetit tonë, dhe do ta riorganizojnë politikën dhe shoqërinë.

Inteligjenca Artificiale Gjeneruese paraqet një sfidë filozofike dhe praktike në një shkallë të paprecedentë që nga fillimi i Epokës së Iluminizimit. Shtypshkronja u dha dikur mundësi studiuësve që të përsërisin shpejt gjetjet e njëri-tjetrit dhe t'i ndanin ato me të tjerët.

Një konsolidim dhe përhapje e paprecedentë e informacionit solli metodën shkencore. Ajo që kishte qenë e padepërtueshme u bë pikënisja e përshpejtimit të pyetjeve. Interpretimi mesjetar i

botës, i bazuar në besimin fetar, u minua në mënyrë progresive. Mund të eksploroheshin thellësitë e Universit derisa të arriheshin kufijtë e rinj të të kuptuarit njerëzor.

Ngjashëm, Inteligjenca Artificiale Gjeneruese do të hapë një rrugë të re revolucionare për arsyen njerëzore dhe horizontet e reja për njohuritë e konsoliduara. Por ndërkohë ekzistojnë disa dallime thelbësore. Njohuritë gjatë Iluminizimit u arritën në mënyrë progresive, hap pas hapi, të ndjekur nga çdo hap i testueshëm dhe i mësueshëm.

Ndërkohë sistemet e aktivizuara nga Inteligjenca Artificiale (AI) mund të ruajnë dhe distilojnë një sasi të madhe informacioni ekzistues. Dhe në rastin e ChatGPT një sasi të madhe materialesh dhe një numër të madh librash. Mbajtja e atij vëllimi informacioni dhe përpunimi i tij është përtej kapacitetit të njeriut.

Metodat e sofistikuar të AI prodhojnë rezultate pa shpjeguar pse apo si funksionon procesi i tyre. ChatGPT vepron pas një pyetje të bërë nga një njeri. Makinaria përgjigjet me tekst brenda sekondave. Ajo është në gjendje ta bëjë këtë sepse përmban të dhëna të shumta, dhe është trajnuar për përdorimin e tyre.

Kapacitetet e AI nuk janë statike. Ato zgjerohen në mënyrë eksponenciale me përparimin e teknologjisë. Kohët e fundit, kompleksiteti i modeleve të AI është dyfishuar çdo disa muaj. Prandaj, sistemet gjeneruese të AI kanë aftësi të mbeten të pazbuluara edhe për shpikësit e tyre. Ndaj e ardhmja jonë bart tani një element krejtësisht të ri të misterit, rrezikut dhe befasisë.

Ne i kërkuam ChatGPT të shpjegonte aftësitë e veta. A mund të parashikojë të ardhmen?

Jo, u përgjig ai. “Unë mund të jap

informacion dhe t’u përgjigjem pyetjeve, vetëm në bazë të të dhënave për të cilat jam trajnuar. Unë nuk kam përvoja personale apo vetëdije, prandaj nuk jam në gjendje të bëj parashikime për ngjarjet e ardhshme” - shtoi ai.

Por a është në gjendje të bëjë gjykime probabilitiste? “Unë mund të jap gjykime probabilitiste bazuar në të dhënat mbi të cilat jam trajnuar. Për shembull, nëse jam trajnuar për një grup të madh të dhënash të modeleve të motit, mund të jem në gjendje të jap një gjykim probabilitistik në lidhje me gjasat që të ndodhë një lloj i caktuar moti në një vend të caktuar në një ditë të caktuar. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto gjykime probabilitiste bazohen në modele dhe tendenca të të dhënave, dhe ato mund të mos pasqyrojnë gjithmonë me saktësi rezultatet e botës reale”

Ne e pyetëm ChatGPT për çështje me interes të madh për momentin, si për shembull mbi rolin e Rusisë në ruajtjen ose minimin e stabilitetit evropian. Ai dha përgjigje në dukje të menduara dhe të përmbledhura në më pak se një minutë, duke balancuar informacione kontradiktore dhe duke u përgjigjur pa u dukur se kishte një mendim të përpunuar.

Nga ana tjetër, Inteligjenca Artificiale gjeneruese duket mbinjerëzore, ose të paktën shumë e zgjeruar në aspektin e aftësive njohëse. Për përdoruesit naivë, ai mund të duket si shumë i shpejtë dhe shumë i artikuluar. Ai e lehtëson përmbledhjen dhe shqyrtimin e njohurive të botës në një mënyrë shumë më efektive sesa çdo lloj programi tjetër ekzistues teknologjik ose njerëzor, dhe këtë e bën me një gjithë-përfshirje unike.

Aftësia e tij për të integruar fusha të shumta njohurish, dhe për të

imituar aspekte të shumta të mendimit njerëzor e bën atë një polimat në një shkallë që tejkalon ambicet e çdo grupi njerëzish të nivelit të lartë. Të gjitha këto cilësi inkurajojnë pranimin e padiskutueshëm të çdo gjëje që generon GPT dhe një lloj atmosfere magjike mbi funksionimin e tij.

Brenda pak ditësh nga fillimi i funksionimit të ChatGPT, më shumë se 1 milionë njerëz u regjistruan për t’i bërë pyetje. Qindra kompani janë duke punuar në teknologjitë gjeneruese me shumë investime. Më të mëdhenjtë prej këtyre modeleve janë të kushtueshme për t’u trajnuar: 1 miliardë dollarë për model. Pasi të trajnohen, mijëra kompjuterë punojnë 24 orë në ditë për t’i përdorur ato.

Ky zhvillim do të ndryshojë shumë fusha, si për shembull arsimin dhe biologjinë. Aftësitë e tyre – nga shkrimi i batutave tek vizatimi i pikturave deri tek dizajnimi i antitrupave – ka të ngjarë të vazhdojnë të na befasojnë. Rëndësia afatgjatë e Inteligjencës Artificiale gjeneruese i kapërcen pasojat tregtare apo edhe përparimet shkencore jokomerciale.

Nuk është vetëm gjenerimi i përgjigjeve. ChatGPT gjeneron pyetje të thella filozofike. Ai do të ndikojë tek diplomacia dhe strategjitë e sigurisë. Megjithatë, asnjë nga krijuesit e kësaj teknologjie nuk po adreson problemet që do të krijojë vetë kjo teknologji. As qeveria amerikane nuk i ka trajtuar ndryshimet dhe transformimet thelbësore që po ndodhin.

ChatGPT nuk ka një personalitet të dukshëm, megjithëse përdoruesit e tij e kanë nxitur herë pas here të veprojnë si binjaku i tij i keq. Mungesa e një autori të

identifikueshëm në ChatGPT e bën më të vështirë për njerëzit që të kuptojnë prirjet e tij sesa do të ishte në rastin e gjykimit të një këndvështrimi politik apo shoqëror të një qenieje njerëzore. Arsimi në veçanti do të duhet të përshtatet me këtë revolucion të ri. Sistemet tona arsimore dhe profesionale duhet të ruajnë një vizion të njerëzve si krijesa morale, psikologjike dhe strategjike që janë uniksht të afta për të dhënë gjykime tërësore.

Makinieritë do të evoluojnë shumë më shpejt sesa gjenet tona, duke shkaktuar një dislokim të brendshëm dhe një divergjencë ndërkombëtare. Ne duhet t’i përgjigjem me maturi proporcionale, veçanërisht në filozofi dhe konceptualizëm, në nivel kombëtar dhe global. Harmonizimi global do të duhet të shfaqet ose nga perceptimi ose nga katastrofa, siç e parashikoi Emanuel Kant 3 shekuj më parë.

Ne duhet të përfshijmë një paralajmërim për këtë parashikim: Çfarë ndodh nëse kjo teknologji nuk mund të kontrollohet plotësisht? Po sikur të ketë gjithmonë mënyra për të gjeneruar gënjeshtër, fotografi false dhe video të mësojnë kurrë të mos besojnë atë që shohin dhe dëgjojnë? / “Wall Street Journal” – Bota.al

Shënim: Henry Kissinger shërbeu si Sekretar Amerikan i Shtetit në vitet 1973-1977. Schmid ka qenë drejtor ekzekutiv i Google në vitet 2001-11. Ndërsa Hattenlosher është dekan i Kolegjit Shvarzman të Informatikës në Institutin e Teknologjisë në Massachusetts. Ata janë autorë të librit “Epoka e Inteligjencës Artificiale dhe e ardhmja e njerëzimit”.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Ministri Çeku: Procesi i licencimit të federatave, drejt përfundimit



PRISHTINË, 28 SHKURT - Ministri i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Hajrulla Çeku, ka thënë se procesi i licencimit të federatave, i cili ka nisur vitin e kaluar, po shkon drejt përfundimit. Çeku në "Facebook" ka bërë me dije se janë licencuar 19 federata të cilat tashmë kanë nënshkruar edhe marrëveshje për financim vjetor. "Procesi i licencimit të federatave të sportit po shkon drejt përfundimit. Deri tani janë licencuar 19 federata, me të cilat sot nënshkruam marrëveshjet vjetore për mbështetje financiare", ka shkruar Çeku. Ai ka shtuar se shumica financiare për mbështetje të federatave do të shkojë deri në rreth 8 milionë euro. "Vlera totale e përkrahjes financiare këtë vit për federatat sportive, Komitetin Olimpik të Kosovës dhe Komitetin Paralimpik është afër 5 milionë euro dhe 3 milionë të tjera janë paraparë mbështetje për programe të veçanta", ka shtuar Çeku.

Kupa sjell përballjen Prishtina - Ballkani

PRISHTINË, 28 SHKURT - Të martën është bërë tërheqja e shortit për fazën çerekfinale të Kupës së Kosovës në Futboll. Të pranishëm në short, krahas anëtarëve të Komisionit të Garave, ishin edhe anëtarët e KE-së, Naser Ajeti, si dhe përfaqësuesit e klubeve pjesëmarrëse në këtë fazë. Ky rreth sjell ndeshje mjaft interesante. Fituesi i edicionit të kaluar, Llapi, do të ketë punë me Malishevën në "Zahir Pajaziti", ndërsa Prishtina do të luajë si vendase përballë kampionit në fuqi të Superligës, Ballkanit. Përballje joshëse pritet edhe në duelin Trepça '89 - Gjilani, që do të luhet në "Riza Lushta", teksa skuadra e Vushtrrisë ishte me fat në short, ngaqë si kundërshtar do ta ketë skuadrën e Ligës së Dytë,

Beharin. Ndeshjet e fazës çerekfinale zhvillohen më 15 mars.

Beharin. Ndeshjet e fazës çerekfinale zhvillohen më 15 mars.

ÇIFTET E ÇEREKFINALES

Trepça '89 - Gjilani
Llapi - Malisheva
Vushtrria - Behari
Prishtina - Ballkani



FBK-ja lejon pjesëmarrjen e tifozëve në mënyrë të organizuar



PRISHTINË, 28 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës i ka gëzuar tifozët e basketbollit me vendimin e saj më të ri. FBK-ja e ka shfuqizuar vendimin për ndalimin e pjesëmarrjes së tifozëve në mënyrë të organizuar në palestra sportive pas problemeve dhe incidenteve të shumta që kishin ndodhur në këtë sezon. Bordi i FBK-së, në mbledhjen e tij të mbajtur të martën, vendosi t'ua lejojë pjesëmarrjen tifozëve me shpresën që nuk do të ketë incidente në pjesën "e nxehtë" të sezonit. "Kjo si rrjedhojë e njoftimit/rekomandimit nga Këshilli për Parandalimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive (Këshilli për Sport), ku u potencua se, duke marrë parasysh që prej periudhës kur FBK ka marrë vendime në lidhje me tifozëritë (15.12.2022) nuk ka pasur probleme të mëdha, kjo pikë mund të shfuqizohet. Prandaj, deri në vendimin tjetër, lejohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit të organizuara nga FBK", thuhet në njoftimin e FBK-së.

të mbajtur të martën, vendosi t'ua lejojë pjesëmarrjen tifozëve me shpresën që nuk do të ketë incidente në pjesën "e nxehtë" të sezonit. "Kjo si rrjedhojë e njoftimit/rekomandimit nga Këshilli për Parandalimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive (Këshilli për Sport), ku u potencua se, duke marrë parasysh që prej periudhës kur FBK ka marrë vendime në lidhje me tifozëritë (15.12.2022) nuk ka pasur probleme të mëdha, kjo pikë mund të shfuqizohet. Prandaj, deri në vendimin tjetër, lejohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit të organizuara nga FBK", thuhet në njoftimin e FBK-së.

të mbajtur të martën, vendosi t'ua lejojë pjesëmarrjen tifozëve me shpresën që nuk do të ketë incidente në pjesën "e nxehtë" të sezonit. "Kjo si rrjedhojë e njoftimit/rekomandimit nga Këshilli për Parandalimin e Dhunës dhe Dukurive Negative në Ngjarjet Sportive (Këshilli për Sport), ku u potencua se, duke marrë parasysh që prej periudhës kur FBK ka marrë vendime në lidhje me tifozëritë (15.12.2022) nuk ka pasur probleme të mëdha, kjo pikë mund të shfuqizohet. Prandaj, deri në vendimin tjetër, lejohet pjesëmarrja në mënyrë të organizuar dhe me çfarëdo shenje dalluese e të gjitha grupeve të tifozëve në ndeshjet e basketbollit të organizuara nga FBK", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Kosova U17, në grup me Sllovakinë dhe Poloninë

PRISHTINË, 28 SHKURT - Të martën është tërhequr shorti për kampionatet evropiane në hendboll për grupmoshat e reja (vajzat) që mbahen në verë.

Hendbollistet e Kosovës U17 do të paraqiten në Evropianin e Divizionit B në Ankara të Turqisë. Shorti ka përcaktuar që Kosova U17 të jetë në Grupin B së bashku me Sllovakinë, Poloninë, Finlandën dhe Bullgarinë. Grupi vlerësohet i fortë. Në Grupin A janë Austria, Italia, Turqia, Letonia dhe Britania e Madhe. Evropiani në Ankara mbahet prej 5 deri më 13 gusht. Aktualisht Përfaqësuesja U17 e Kosovës po paraqitet në Kampionatin Mesdhetar në Greqi.

Hendbollistet e Kosovës U17 do të paraqiten në Evropianin e Divizionit B në Ankara të Turqisë. Shorti ka përcaktuar që Kosova U17 të jetë në Grupin B së bashku me Sllovakinë, Poloninë, Finlandën dhe Bullgarinë. Grupi vlerësohet i fortë. Në Grupin A janë Austria, Italia, Turqia, Letonia dhe Britania e Madhe. Evropiani në Ankara mbahet prej 5 deri më 13 gusht. Aktualisht Përfaqësuesja U17 e Kosovës po paraqitet në Kampionatin Mesdhetar në Greqi.

Hendbollistet e Kosovës U17 do të paraqiten në Evropianin e Divizionit B në Ankara të Turqisë. Shorti ka përcaktuar që Kosova U17 të jetë në Grupin B së bashku me Sllovakinë, Poloninë, Finlandën dhe Bullgarinë. Grupi vlerësohet i fortë. Në Grupin A janë Austria, Italia, Turqia, Letonia dhe Britania e Madhe. Evropiani në Ankara mbahet prej 5 deri më 13 gusht. Aktualisht Përfaqësuesja U17 e Kosovës po paraqitet në Kampionatin Mesdhetar në Greqi.



Gega: Kërkoj rekordin ballkanik në 5 000 metra në garën e rrugës

TIRANË, 28 SHKURT - Kampionia e Evropës në atletikë, Luiza Gega, kërkon suksese të tjera. Ajo thotë se synon ta thyjë rekordin ballkanik në garën e 5 000 metrave në rrugë. "Kemi vendosur të bëjmë një test

tjetër sepse dua ta thyej rekordin ballkanik në garën 5 000 metra të rrugës që do të jetë më 19 mars. Kam shumë dëshirë ndoshta në të ardhmen t'i shikoj garat e rrugës si gara kryesore, sigurisht do të mbetet

për t'u parë pas Paris 2024", ka thënë ajo për "Tv Klan". Përveç Kampionatit Botëror që do të mbahet në muajin gusht në Budapest, Luiza Gega do të fokusohet edhe te Diamond League, turneu më elitare në

atletikë. "Këtë vit kemi vetëm Botërorin si garë të madhe. Fokusi im këtë vit do të jenë Diamond League. Në fillim të majit do të jetë Diamond League e parë dhe do të marr pjesë në Doha", ka shtuar Gega.



Qerimi shpall listën për dy ndeshjet me Bosnjë-Hercegovinën

PRISHTINË, 28 SHKURT - Selektori i Përfaqësueses së Kosovës, Bujar Qerimi, ka shpallur të martën listën me emrat e hendbollistëve në të cilët llogaritet për dy ndeshjet me Bosnjë-Hercegovinën. Kosova e pret Bosnjë-Hercegovinën më 8 mars në Prishtinë, ndërsa ndeshja tjetër me boshnjakët është më 12 mars në Tuzla. Kosova e Bosnjë-Hercegovina janë në Grupin 7 të kualifikimeve për "Euro 2024". Të dyja kombëtaret i kanë humbur ndeshjet e para, ndërsa ndeshjet e ndërsjella vlerësohen vendimtare për vendin e tretë, që mund të dërgojë në Evropian. Synimi i Kosovës është vendi i tretë në grup, ndërsa shumë e rëndësishme vlerësohet ndeshja e 8 marsit në Prishtinë. Përfaqësuesja e Kosovës grumbullohet më 5 mars në Prishtinë. Selektori Qerimi ka ftuar 19 lojtarë në grumbullim. Ka të rikthyer po ashtu emra të rinj. Janë kthyer kapiteni Valon Dedaj, Bujar Ramosaj e Shaban Zogaj,



Lista e hendbollistëve

Kastriot Jupa, Valon Dedaj, Flamur Gërbeshi, Drenit Tahirukaj, Arbios Mushkolaj, Luigj Quni, Drilon Tahirukaj, Lulzim Shabani, Haris Berisha, Bujar Ramosaj, Jon Muqolli, Leonard Gegaj, Rron Ramadani, Atthe Basholli, Ardin Berisha, Egzon Gjuka, Matej Thaqi, Elvir Muqaj Koliq, Shaban Zogaj.

ndërsa Ardin Berisha e Elvir Muqaj janë emra të rinj në përfaqësuese. Mali i Zi dhe Sllovenia udhëheqin në grup me nga katër pikë.

Bostoni humbet ndeshjen dhe kreun në Lindje, Miami rikthehet te fitorja

NJU-YORK, 28 SHKURT - Bostoni u mund me rezultat 109-94 nga New Yorku, një humbje që ka zbritur ekipin e Celticsit nga vendi i parë në Konferencën e Lindjes, ku tashmë ndodhet Milwaukee. Vendimtar stoli i New Yorkut, nga ku erdhën 44 pikë, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Randle me 23 pikë. Te Bostoni zhgënjyesh të gjithë lojtarët "big". Rikthehet te fitorja ekipi i Miamit, që mundi me rezultat 101-99 rivalët e Philadelphia. Jimmy Butler me 23 pikë e 11 rebounde ishte lojtari më i mirë për miqtë, vendimtar në këtë fitore. Për vendasit, Embiid realizoi 27 pikë e 12



rebounde, por që mbetën për statistikë. Fitoi edhe skuadra e Charlottes, që mposhti me rezultat 117-106 Detroitin. Rozier me 22 pikë bëri diferencën në fushë për vendasit. Ekipi i

Orlandos arriti një fitore të rëndësishme ndaj New Orleansit me shifrat 101-93, duke shpresuar ende për "play-off"-in. Banchero me 29 pikë ishte më i miri në fushë për miqtë.

REZULTATET

Charlotte - Detroit	117-106
Philadelphia - Miami	99-101
New York - Boston	109-94
New Orleans - Orlando	93-101

Çështja Zidane dhe akuzat për ngacmim seksual, Le Graet jep dorëheqje

Noel Le Graet ka dhënë dorëheqje si president i Federatës Franceze të Futbollit (FFF), duke mos e mbyllur dot mandatin e katërt. 81-vjeçari u përballë

me një hetim të Prokurorisë së Parisit për ngacmim seksual. Akuzat u hodhën nga Sonia Soudi, agente e futbollistëve dhe futbollisteve të ndryshme. Le

Graet shkaktoi polemika edhe në lidhje me deklaratën e tij kundrejt Zinedine Zidane: "Nuk më intereson nëse Zidane merr drejtimin e Brazilit. Nuk do t'ia kisha

hapur telefonin nëse do të më telefononte për t'u interesuar për postin e trajnerit të Francës". Me dorëheqjen e sotme merr fund aventura 12-vjeçare e tij

në krye të futbollit francez. Suksesi më i madh u arrit në Botërorin Rusi 2018, aty ku kombëtarja franceze siguroi Kupën e Botës për herë të dytë në histori.

SHKURT

Messi pas çmimit që mori nga FIFA: Faleminderit të gjithëve!

FIFA e zgjodhi mbrëmë Lionel Messin futbollistin më të mirë të vitit në botë. Ylli argjentinas ndihet mjaft i lumtur që u kurorëzua për herë të shtatë me këtë çmim prestigjioz individual. "Faleminderit të gjithë atyre që e bënë të mundshme që ta fitoj këtë çmim! Krejt ata të Federatës argjentinasë, Kombëtaren e Argjentinës, familjen dhe miqtë e mi, 45 milionë argjentinas që besuan në ne... Dhe, urime të gjithë fituesve dhe fitueseve të 'FIFA The Best', posaçërisht Lio Scaloni dhe Dibu, të cilët, po ashtu, i morën me plot meritë premitë. Një përqafim për të gjithë. Do të shihemi së shpejti", ka shkruar Messi.

Alonso: Ne do të jemi rivalët e Red Bullit për titull

Testet dimërore të Formulës 1 zhvilluar pak ditë më parë në pistën e Bahreinit treguan se makina Aston Martin është një rivale e fortë. Rezultatet e konfirmuan këtë gjë, ndaj dy herë kampioni i botës Fernando Alonso beson se këtë sezon do të ketë mundësi të duelojë për fitoren. Piloti spanjoll, duke analizuar kohët, sqaron: "Ditën e fundit bëmë një simulim gare, me 57 xhiro, ndërrim gomash, karburant etj. dhe gjërat shkuan mirë. Të njëjtën gjë bëri edhe Ferrari dhe nga të dhënat doli se ne ishim pak më të shpejtë se ai në pistë. Kjo na jep besim se do të jemi kompetitivë edhe këtë fundjavë në garën e parë sezonale në Bahrein. Mendoj se ne do të jemi forca e dytë e këtij sezoni pas Red Bullit, duke lënë pas Ferrarin e Mercedesin. Të paktën në garat e para, por shpresoj shumë që zhvillimi i makinës t'i japë frytet e saj", ka deklaruar Alonso.

'Fenomeni' zgjedh 11-shen më të mirë të të gjitha kohëve

Ronaldo "Fenomeni" ka zgjedhur skuadrën më të mirë të të gjitha kohëve. Qendërsulmuesi i famshëm brazilian e përfshiu veten në atë njëmbëdhjetëshë, por jo edhe portugezin Cristiano Ronaldo. Trajneri ideal i Ronaldos është bashkëkombësi i tij Zagalo dhe skuadra dominohet nga brazilianët, raporton "Globo". Në portë është italiani Gianluigi Buffon. Në të djathtë të mbrojtjes është Cafu, ndërsa në të majtë është Roberto Carlos. Në qendër të mbrojtjes janë gjermani Franz Beckenbauer dhe italianu Paolo Maldini. Në mesfushë Ronaldo zgjodhi bashkatdhetarin Zico dhe argjentinasin Diego Armando Maradona, kurse në sulm argjentinasin Lionel Messi dhe brazilianët Pele, Ronaldinho dhe Ronaldo (Fenomeni).

Mbappe: Në Serinë A do të luaja për Milanin

Kylian Mbappe i ka bërë tifozët e Milanit të ëndërrojnë përkohësisht. Ylli francez i është përgjigjur një tifozi para fillimit të ceremonisë së ndarjes së çmimeve të më të mirëve për vitin 2022 që u mbajt në Paris të Francës. Në përgjigje të pyetjes për një të ardhme eventuale në Itali, ylli i Paris Saint-Germainit dhe i Kombëtarses së Francës u përgjigj: "Nëse do të vija në Serinë A do ta bëja këtë për Milanin". Natyrisht, një mundësi e tillë për momentin është thuajse zero duke e pasur parasysh rrogën e tij stratosferike dhe qindra miliona eurot që i kërkon PSG-ja për shitjen e lojtarit i cili shihet më afër transferimit në Real Madrid.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e 1 (një) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

Kuvendi shpall konkurs për plotësimin e pozitës:

1 (një) anëtar/e, siç përcaktohet me nenin 108 paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga radhët e gjyqtarëve.

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, duhet t' i plotësojë kushtet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, dhe aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia së është emëruar gjyqtar me mandat të përhershëm;
- Dëshmia se ndaj ti nuk është shqiptuar ndonjë masë disiplinore.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 20 mars 2023, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

K O N K U R S

Za izbor 1 (jednog) člana u Sudskom savetu Kosova

U skladu sa članom 10. Zakona br. 06/L-055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze izbora članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

Skupština raspisuje konkurs za popunjavanje radnog mesta:

1 (jedan) član, kako je definisano članom 108. stav 6. podstav 3. Ustava Republike Kosovo iz redova sudija.

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo mora da ispunjava uslove utvrđene Ustavom i Zakonom o Sudskom savetu, a uz prijavu moraju biti priloženi sledeći dokumenti:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o imenovanju za sudiju sa stalnim mandatom;
- Dokaz da vam nije izrečena disciplinska mera.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 20. marta 2023. godine u 16.00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosovo, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikaciju možete uzeti u:

Štampanoj formi: na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u *Elektronskoj formi:* internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



K.R.U. "Drini i Bardhë" SHA
Rr. Mbretëresha Teutë nr.85
www.krudriniibardhe.com

Në bazë të rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave të punës, KRU "Drini i Bardhë" Sh.A, me datën 28.02.2023, vendosi të publikoj këtë:

KONKURS

Pozita: Inkasantë sezonal për teren, me kontrate gjashtë (6) muaj me mundësi vazhdimi. Vendi Pejë: (3 pozita), Deçan: (3 pozita), Gurrakoc: (2 pozita).

Detyrat e punës janë:

-Bëjnë pastrimin e kanaleve të ujit sipas planifikimit nga Menaxheri i Njësisë, bëjnë kontraktimin e ujit, shpërndarjen e ujit, dhe pagesat nga fermerët, më rastin e pagesave janë të obliguar të lëshojnë kontrata dhe dëftesat e pagesave.

Kushtet për themelimin e marrëdhënies së punës.

- Kualifikimi i mesëm shkollor.

Procedura e aplikimit:

Dokumentet dorëzohen në zyrën nr. 1 të KRU "Drini i Bardhë" rruga "Mbretëresha Teutë" Nr. 85 Pejë.

Aplikacionit duhet bashkëngjitur edhe këto dokumente:

- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Diplomën shkollore për kualifikimin e kërkuar - kopje,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj.

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit dhe përfundon në ora 16:00, të ditës gjegjëse.



Shkolla e Mesme e Profesionale "Ymer Prizreni" Prizren

Kosovë 20000 Prizren rr.Bajram Curri p.n
Nr.tel.038/20035377
e-mail:mgavazaj@hotmail.com



Nr.protokoli-238/2023

Në bazë të Rregullorës nr.01/2017,datë 02.02.2017, Ligjit NR.04/L-143, nenit 12 për Arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës, Drejtoresha e IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren, vendos për pranimin e nxënësve në arsimin për të rritur dhe me këtë rast publikon këtë:

KONKURS

EKONOMI

- 1.Kontabilitet e tatime..... 1 paralel 24 nxënës
2.Tregti me pakicë e shumicë..... 1 paralel 24 nxënës

HOTELERI

- 1.Asistent restoranti.....1 paralel 24 nxënës

TEKNOLOGJI USHQIMORE

- 1.Teknologji ushqimore.....1 paralele 24 nxënës

ADMINISTRATË

- 1.Administrim dhe shërbime të zyrës..... 1 paralel 24 nxënës

AGROBIZNES

1. Agrobiznes

Kushtet:

Dokumentacioni (dëftesa e shkollimit paraprak,certifikata e lindjes, dhe letërnjoftimi i fotokopjuar).

Pagesa bëhet sipas rregullores së MASHT-it Nr.11/2011 Dt.:30.12.2011 dhe Rregullores për tarifa,taksa,ngarkesa dhe gjoba nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale nr.01/11.

1. Për regjistrimin e vitit për një klasë: 100 €
2. Praktika profesionale 50 €
3. Lënda me shkrim dhe me gojë 10 €
4. Lënda me gojë 8€
5. Për diplomë(përfundimi i shkollimit): 50€
6. Provimet diferenciale 10€

Vijueshmëria në mësim

Kandidatët e pranuar janë të obliguar që t'i ndjekin 18 javë mësimi nëse klasa e profilit përkatës numëron mbi 15 nxënës, dhe në fund t'i nënshtrihen testit vlerësues në të gjitha lëndët e parapara për arsimin për të rritur.

Për klasë ku numri i nxënësve është nën 15 nxënës, organizohet mësimi konsultativ.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

Drejtorja e Gjinnazit "Remzi Ademaj" në Prizren
Nr.prot: 210/2023 datë 28.02.2023

Bazuar në nenin 11 të Udhëzimit Administrativ – Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, vendimi nr. 192/2023 të datës 22.02.2023 nga KDSH, drejtorja e gjinnazit "Remzi Ademaj" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të gjinnazit "Remzi Ademaj" në Prizren

Ftojme ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të gjinnazit "Remzi Ademaj" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën **08.05.2023 deri më 12.05.2023.**

Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të jetë i licensuar (licenca e agjencisë turistike)
- Certifikata e agjencionit transportues
- Të ketë bërë kontrollin teknik sipas procedurave ligjore,
- Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore,
- Certifikata e autobusit sipas licencës D
- Licencën e transportit ndërkombëtar D
- Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës mbi 300 vende
- Autobusët të jenë komforë dhe me klimë,
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi, certifikatë pune me diplomë të mjekut që shoqëron nxënësit.
- Dëshmi për rezervimin e hotelit për datën 08.05.2023 deri më 12.05.2023.
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve.
- Certifikatat e shoferëve (CPC)
- Referencat rreth organizimit të ekskursioneve me maturantë.
- Certifikatën e biznesit me informata për biznesin,
- Vërtetim për pagesën e tatimit në pronë
- Të prezantohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë mbi 300 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapësirë të mjaftueshme mbi 300 vende për ushqim në tri vaktet kriter i përcaktuar nga KDSH.
- Hoteli të posedojë sallë për argëtim së paku për 300 nxënës dhe të mos shërbehen pije alkoolike për nxënës kriter i KDSH.
- Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës përcaktuar nga KDSH.
- Gjatë vizitave nëpër monumente pagesa për nxënës të sigurohet nga kompania kriter i KDSH.
- Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në ekskursion kriter i KDSH.
- Agjencioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit, kriter i KDSH

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimit mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuar me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimin në Prizren.

Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 me datë 07.03.2023 në ora 16:00 në ambientet e DKA Prizren ku mund të marrin pjesë edhe ofertuesit.

Pas hapjes së ofertave, Komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kompanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.

Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania turistike e përgjegjshme me çmimin më të ulët të ofertës.

Drejtorja e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Andi Isufi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu "Ahmet Rustemi" Bec nga kl. I-V dhe VI-IX KK Gjakovë.

Aida Boshnjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm Mjekësisë "Hysni Zajmi".

Zylfi Kastrati Ratkoc KK Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "12 Maji" Ratkoc KK Rahovec.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS


Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË



pa konservues